
**UDHËZUES PËR MËSIMIN NË DISTANCË
PËR STUDENTËT**

Tiranë, 2020

PËRMBAJTJA

I. UDHËZIME DHE KËSHILLA PËR MËSIMIN NË DISTANCË

A. FORMA TË MËSIMIT NË DISTANCË

B. TIPOLOGJI PËR MËSIMIN NË DISTANCË

1. VEPRIMTARI PËR NJOHURI
2. VEPRIMTARI PËR ZHVILLIM AFTËSISH
3. LLOJE PUNIMESH PËR MËSIMIN NË DISTANCË

C. LLOJE DHE FORMATE TË PUNIMEVE TË NDRYSHME PËR VLERËSIM

1. STUDIMI I RASTIT
2. PLATFORMA E DOKUMENTIT TË POLITIKËS
3. ESEJA
4. POSTSERI
5. DOSJA ELEKTRONIKE

D. UDHËZIM PËR ZHVILLIMIN E ORËVE LABORATORIKE, PRAKTIKUMEVE DHE PRAKTIKAVE MËSIMORE VIRTUALE

E. POLITIKA E VLERËSIMIT NË DISTANCË NË UST

1. PARIME TË VLERËSIMIT NË DISTANCË
2. FORMA DHE PROCEDURA TË VLERËSIMIT NË DISTANCË PËR ARRITJET LËNDORE DHE DETYRIMET PËRMBYLLËSE
 - a. PROVIM ME GOJË ONLINE PËR 15 MINUTA PËR ÇDO STUDENT NËPËRMJET VIDEOKONFERENCËS NË NJË PLATFORMË DIGJITALE
 - b. TEST ME SHKRIM ME PYETJE TË TIPIT OBJEKTIV DHE SUBJEKTIV NËPËRMJET NJË PLATFORME DIGJITALE QË MUNDËSON PËRDORIMIN E TESTEVE
 - c. PROVIM I KRYER NGA SHTËPIA
 - d. DOSJE ELEKTRONIKE E PUNIMEVE TË KURSIT
3. TAKSONOMIA E BLOOMIT: FORMA TË DETYRAVE PËR VLERËSIM NË FUSHËN E NJOHJES

II. KËSHILLA PËR TË ORGANIZUAR TË MËSUARIT NË DISTANCË NË KUSHTET E SHTËPISË

I. UDHËZIME PËR MËSIMIN NË DISTANCË

Zëvendësimi i mësimit ballë për ballë, të ofruar në kampus me mësimin në distancë, përbën një sfidë pedagogjike për të gjithë pedagogët dhe studentët. Për të përballuar sa më mirë këtë sfidë pedagogjike, UST ofron këtë udhëzues i cili do t'ju vijë në ndihmë studentëve për të mësuarit në distancë. Ky udhëzues ofron një numër udhëzimesh dhe këshillash pedagogjike që do të pasurohen gradualisht, duke mbështetur zhvillimin e mësimit në distancë.

Zhvillimi i mësimit në distancë është thelbësisht i ndryshëm nga mësimi në kampus. Pedagogët dhe studentët kanë role të ndryshme nga mësimi në kampus.

Pedagogu do të përmbushë rolin e drejtuesit, mbikëqyrësit, konsulentit, vlerësuesit nga distanca, do të aktivizojë studentët dhe do të përdorë mënyra të tjera për të udhëhequr të nxënit e studentëve. Pedagogu do të shpenzojë më shumë kohë për të përgatitur materialet mësimore të përshtatshme për mësimin në distancë, për kontaktin me studentët, për punë të personalizuar dhe individualizuar, për të dhënë feedback. Pedagogu është përgjegjës për menaxhimin e komunikimit, të mbajtjes së komunikimit në standardet profesionale dhe etike dhe të përmbushjes së standardeve të cilësisë.

Studentët do të kenë një përgjegjësi të shtuar në lidhje me mënyrën sesi ata do të studiojnë në distancë, kur i duhet që të përshtaten shpejt me një formë studimi të papraktikuar më parë, kur i duhet të përdorin në mënyrë të efektshme aftësitë akademike të studimit, që lidhen me organizimin e studimit individual, me strategjitë e stilit të të nxënit, me menaxhimin e kohës në mënyrë të efektshme, me organizimin e kërkimit.

A. FORMA TË MËSIMIT NË DISTANCË

Mësimdhënia në distancë është veprimtaria e institucionit arsimor për të hartuar, zhvilluar dhe shpërndarë në distancë përvoja mësim ore për studentin, në mënyrë që të mund të ndodhë të nxënit.

Të nxënit në distancë është një mënyrë për të mësuar nga distanca, pa qenë në kontakt të rregullt ballë për ballë me një pedagog në klasë.

Mësimi asinkron në distancë do të thotë "mësim jo në të njëjtën kohë". Mjetet asinkrone, të tilla si posta elektronike dhe paneli i diskutimit, lejojnë pjesëmarrësit të komunikojnë pa pasur nevojë të jenë online në të njëjtën kohë. Mësimi asinkron në distancë kryeht bazuar në disa afate javore. Mësimi asinkron në distancë u jep studentëve lirinë për të punuar sipas dëshirës së tyre. Studentët mund të kenë më shumë ndërveprim me studentët e tjerë.

Mësimi sinkron në distancë do të thotë "mësim që ndodh në të njëjtën kohë". Mjetet sinkron, të tilla si biseda me tekst, biseda audio ose biseda video, lejojnë të gjithë pjesëmarrësit të jenë online në të njëjtën kohë. Ditët dhe orët për seancat sinkron duhet të publikohen. Mësimi sinkron në distancë kërkon komunikim të drejtpërdrejtë përmes internetit. Mësimi sinkron në distancë është zakonisht më pak fleksibël.

Mësimi i përzier në distancë është në të vërtetë kombinimi i mësimit asinkron dhe sinkron në të cilin studentët duhet të ndjekin afate të caktuara për të përfunduar detyrat e tyre. Studentët e organizojnë vetë kohën për detyrat dhe i paraqesin ato përmes forumit në internet.

Mësimi i përzier është një përzierje e mësimit në distancë me mësimin tradicional në klasë. Studentët takohen ballë për ballë për 50% ose më pak të kohës së kursit dhe plotësojnë pjesën tjetër të lëndës së tyre nëpërmjet lidhjes në internet. Seancat ballë për ballë do të planifikohen në një vend të caktuar në ditë dhe orë të caktuara. Datat, orët dhe vendndodhjet për takime ballë për ballë duhet të publikohen në orarin zyrtar të mësimit të universitetit. Seancat e drejtpërdrejta ballë për ballë duhet të jenë të palnifikuara për të rritur përvojën arsimore dhe bashkëveprimin midis pedagogëve dhe studentëve.

Mësimi në distancë me orar të hapur. Studentët kanë liri të madhe me mësimin me orar të hapur. Kjo është nënkategori e mësimit asinkron, ku studentëve u jepen tekste nëpërmjet internetit, u dërgohen udhëzime nëpërmjet e-mail-it dhe forumeve për të përfunduar punën e tyre të kursit. Fillimisht, studentëve u jepen një sërë afatesh për të përfunduar punën e tyre dhe lejohen të punojnë me ritmin e tyre. Mësimet në distancë me orar të hapur janë jashtëzakonisht të vlefshme për studentët që duan të punojnë në mënyrë të pavarur.

Mësimi në distancë me orar të fiksuar. Kjo është nënkategori e mësimit sinkron, ku studentëve u jepen tekste nëpërmjet internetit, u dërgohen udhëzime nëpërmjet e-mail-it dhe forumeve për të kryer detyra të ndryshme, por ata janë online me pedagogun në orare të përcaktuara dhe të

shpalluara më parë. Mësimi në distancë me orar të fiksuar zakonisht realizohet nëpërmjet audio, video, web konferencave. Mësimi në distancë me orar të fiksuar përdoret për prezantim të njohurive, për sqarime dhe udhëzime për detyrat dhe punimet, për të diskutuar çështje të rëndësishme, për të prezantuar detyra, për të dhënë fidbek për punimet e studenëve.

B. TIPOLOGJI PËR MËSIMIN NË DISTANCË

1. VEPRIMTARI PËR NJOHURI

- ⊗ Leksion (me anë të PPT, paraqitje e shënimeve të përmbledhura, video, audio)
- ⊗ Panel i ekspertëve me dy-tre studentë që paraqesin sinkron ose në mënyrë të shkruar asinkron informacion për një ose dy çështje të temës

2. VEPRIMTARI PËR ZHVILLIM AFTËSISH

- ⊗ Studim rasti. Paraqitje nga pedagogu i rasteve të studimit, si një mundësi për analizë, interpretim, vlerësim
- ⊗ Formulim dhe dërgim i pyetjeve nga pedagogu
- ⊗ Formulim i pyetjeve nga studentë
- ⊗ Përdorimi i fletëve të punës për t'u plotësuar ose punuar nga studentët
- ⊗ Fletë ushtrimesh
- ⊗ Punime të shkurtëra 150, 300 fjalë
- ⊗ Ese të shkurtëra 600 fjalë
- ⊗ Punime deri në 2000 fjalë
- ⊗ Projekte
- ⊗ Paraqitje nga studentët e rasteve të studimit
- ⊗ Hartimi i dokumenteve të politikave
- ⊗ Analizë e evidencave të gatshme
- ⊗ Krijim i evidencave
- ⊗ Dhënia e fidbekut nga studentët për detyrat e kryera nga studentët e tjerë
- ⊗ Detyra për reflektim informal, një përgjigje e shpejtë për një çështje të mësimin nëpërmjet chat
- ⊗ Detyra për reflektim formal, një mendim i strukturuar sipas një formati të dhënë paraprakisht nga pedagogu, i cili dërgohet me e-mail ose postohet në platform në rubrikën detyra
- ⊗ Diskutim për një artikull, video, audio, i cili përgatitet me shkrim ose paraqitet në seancat sinkron
- ⊗ Përgatitja e një recensionit për një artikull, libër, video
- ⊗ Përgatitje e dosjeve profesionale me materiale të punuara nga studentët
- ⊗ Përgatitja e raporteve mbi bazën e analizës së evidencave, buletineve

3. LLOJE PUNIMESH PËR MËSIMIN NË DISTANCË

- ⊗ Ese
- ⊗ Platformë e dokumentit të politikës
- ⊗ Studim rasti
- ⊗ Zgjidhje problemi
- ⊗ Vëzhgim
- ⊗ Demonstrim
- ⊗ Simulime virtuale
- ⊗ Projekt
- ⊗ Përgatitje platformash për projekte, dokumente
- ⊗ Poster
- ⊗ Dosje elektronike
- ⊗ Përgatitje protokollesh
- ⊗ Përgatitje evidencash
- ⊗ Analizë evidencash
- ⊗ Analizë të dhënash
- ⊗ Analizë klinike
- ⊗ Wikis-komente
- ⊗ Recensione artikujsh, esesh, tekstesh, raportesh, strategjish
- ⊗ Reflektim për një material, detyrë, ide, teori, hipotezë, video, film
- ⊗ Minikërkime

C. LLOJE DHE FORMATE TË PUNIMEVE TË NDRYSHME PËR VLERËSIM

1. STUDIMI I RASTIT

Me anë të studimit të rastit hulumtohet, studiohet me hollësi një rast, situatë e veçantë, një vendim, një ngjarje ose një çështje. Studimi i rastit nënkupton një studim intensiv të një teme për një periudhë kohe të shkurtër.

Studimet e rasteve zakonisht përfshijnë situata nga jeta reale dhe shpesh marrin formën e një qasjeje të bazuar në problem; me fjalë të tjera, studentëve u prezantohet një situatë e ndërlikuar e jetës reale për të cilën u kërkohet të gjejnë një zgjidhje profesionale për të. Studentët vendosen në rolin e vendimmarrësve dhe duke u kërkuar atyre që të adresojnë një sfidë që mund të përballet me një kompani, një organizatë jofitimprurëse me një departament qeveritar, me një individ, me një politikë, me një çështje.

Kjo teknikë mundëson që të mblidhet informacion i hollësishëm që nuk mund të mblidhet me teknika të tjera. Informacioni i grumbulluar për institucione, individë, për komunitetin mund të shërbejë për institucione, individë, për grupe dhe për komunitete që përballen me të njëjtin rast.

Në mungesë të një përgjigjeje të vetme të drejtpërdrejtë, studentët pritet të shkëmbejnë ide, të marrin në konsideratë shpjegime të mundshme teorike dhe të peshojnë zgjidhje të mundshme. Bazuar në këtë shkëmbim dhe vlerësim të të dhënave të përziera, ata pritet të marrin një vendim, dhe të zgjedhin një zgjidhje për sfidën e veçantë. Megjithatë mësimi dhe vlerësimi i studimit të rastit mund të marrin shumë forma, zakonisht studimi i çështjes përfshin një situatë të jetës reale dhe gjetja e zgjidhjeve është në fokus të vlerësimit.

Tema e studimit të rastit zgjidhet nga lista e temave që paraqet pedagogu ose që propozon studenti.

Formati i studimit të rastit përmban këto elemente:

- ⦿ Faqja prezantuese: Titulli i studimit të rastit, emri/emrat e studentëve, data e dorëzimit të punimit.
- ⦿ Hyrje që përshkruan çështjen duke iu referuar literaturës
- ⦿ Përshkrim i rastit konkret që është marrë në studim
- ⦿ Evidencë për rastin: fakte, probleme, dokumente mbështetëse
- ⦿ Analizë e evidencës së rastit
- ⦿ Rekomandime për zgjidhjen e çështjes ose ndikimin e saj
- ⦿ Referenca

Për të përgatitur një studim rasti përdoren gjashtë tipa të mbledhjes së të dhënave

1. Dokumente
2. Të dhëna arkivore
3. Intervista
4. Vëzhgim i drejtpërdrejtë
5. Vëzhgim i pjesëmarrësve
6. Artefakte: historiko-kulturore, produkte të medias, raporte, modele, plane, strategji, evidenca, të dhëna

Avantazhet e studimit të rastit

- ⊗ I lejon studentët të përdorin njohuritë dhe aftësitë e tyre në situata të jetës reale.
- ⊗ Mund të kryhet si punim individual ose në grup.
- ⊗ Projektohet, në përgjithësi, për të vlerësuar nivelet më të larta të fushës së njohjes, si zbatimi, analiza, vlerësimi.
- ⊗ Përdoret për qëllime lëndore dhe ndër-lëndore.
- ⊗ U mundëson studentëve të demonstrojnë një varg aftësish të ndryshme, siç janë përzgjedhja e informacionit, analiza, zgjidhja e problemit dhe marrja e vendimeve.
- ⊗ Në rastin e një qasjeje të bazuar në grup, studentëve u jepet mundësia të demonstrojnë aftësinë e tyre për të bashkëpunuar dhe komunikuar në mënyrë efektive.
- ⊗ Studimi i rastit rrit motivimin e studentëve.
- ⊗ Studentët shpesh janë shumë të interesuar të punojnë në situata të jetës reale.
- ⊗ Studimi i rastit e sjell të gjallë mësimin dhe u lejon studentëve jo vetëm që të zhvillojnë zgjidhje për situatat / problemet aktuale, por gjithashtu të kuptojnë në mënyra të reja rolin e vlefshëm që teoria dhe konceptet përkatëse mund të luajnë si pjesë e këtij procesi.
- ⊗ Si pjesë e punës së tyre në studimin e rastit, studentët zhvillojnë qartë aftësi të vlefshme, të transferueshme që mund të vlejnë për të ardhmen e tyre.

Sfidat e studimit të rastit

- ⊗ Studimi i rastit mund të përdoret në provime të kufizuara në kohë.
- ⊗ Mund të jetë një veprimtari komplekse që përfshin negociimin e një game të mediave që mund të jenë të vështira për t'u përdorur në një mjedis të kontrolluar.
- ⊗ Studentët mund të mos jenë mësuar me këtë formë të vlerësimit, kështu që ata do të kenë nevojë për udhëzim të qartë për atë që pritet (gjatësia, formati, elementet kryesore), një shpjegim i qartë i kriterëve të vlerësimit, si dhe zhvillim i aftësive të ndryshme që do të duhet të fitojnë në mënyrë që të përfundojnë me sukses studimin e rastit.
- ⊗ Planifikimi dhe përgatitja për studimin e rastit merr kohë për pedagogun.

Besueshmëria, vlefshmëria, drejtësia në vlerësimin e studimit të rastit

- ⊗ Aktivitetet mësimore duhet të jenë të skicuara me kujdes për të mbështetur punën në studimin e rastit ose zhvillimin e aftësive dhe bazave të njohurive përkatëse.
- ⊗ Në çdo rast, është e rëndësishme të sigurohet që studimet e zgjedhura të çështjeve të jenë të arritshme për të gjithë studentët që marrin kursin. Në rastin e studentëve të vitit të parë pedagogu u rekomandon dhe u vë në dispozicion studentëve të gjitha materialet

përkatëse. Për studentët e viteve më të larta, pritët që të bëjnë vetë disa hulumtime dhe të identifikojnë materiale përkatëse mbështetëse për hetimin e studimit të rastit.

- ⊙ Kur studimi i rastit kryhet në grup, një numër opsionesh mund të konsiderohen për të siguruar drejtësi. Studentët mund të plotësojnë disa elemente të punës formuese dhe përmbledhëse si grup, si dhe të tjerët individualisht. Për shembull, studentët mund të kryejnë detyra të ndryshme ose të japin një prezantim mbi studimin e çështjes si grup, por të shkruajnë një pjesë të studimit të çështjes përfundimtare individualisht. Për më tepër, është praktikë relativisht e zakonshme t'u kërkohet studentëve të angazhuar në punë në grupe të shkruajnë një pjesë të shkurtër reflektuese duke diskutuar përvojën e tyre të punës në grup. Studentëve gjithashtu mund t'u kërkohet të vlerësojnë kontributin e tyre dhe kontributin e anëtarëve të tjerë të grupit duke përdorur një numër mjete vlerësimi të grupit në internet.

2. PLATFORMA E DOKUMENTIT TË POLITIKËS

Ky lloj punimi adreson një çështje të politikës bashkëkohore dhe shoqërohet me përgatitjen për prezantim në formë të shkruar dhe / ose me gojë. Dokumentet e politikave zakonisht paraqesin një varg alternativash ndaj politikës aktuale, shoqëruar nga një seri rekomandimesh të bazuara në prova, duke paraqitur alternativën më optimale në kontekstin e dhënë. Dokumenti i politikave duhet të përfshijë prova të mjaftueshme për t'i mundësuar vendimmarrësit të marrin një vendim për rrjedhën pasuese të veprimit. Gjatësia e dokumentit të shkruar të politikave dhe / ose prezantimit me gojë mund të ndryshojnë. Kjo detyrë mund të kryhet individualisht ose në grup.

Për këtë detyrë zgjidhet një nga temat e paraqitura nga pedagogu ose e propozuar nga studenti.

Elemente të dokumentit të politikës

- ⦿ Faqja prezantuese: Titulli i punimit, emrat e studentëve, data e dorëzimit të punimit.
- ⦿ Pëshkrimi i kontekstit aktual dhe i perspektivës së institucionit, agjencisë, organizatës
- ⦿ Përcaktimi i arritjeve dhe i problematikës së çështjes
- ⦿ Paraqitje e politikës kombëtare ose lokale për çështjen
- ⦿ Propozim i politikës për çështjen
- ⦿ Plani i veprimit për realizimin e politikës
- ⦿ Referenca

Avantazhet e dokumentit të politikës

- ⦿ Mundëson që studentët të përfshihen në çështje të botës reale.
- ⦿ Mbështet studentët për të zhvilluar aftësi në zgjedhjen dhe përdorimin e provave empirike për të mbështetur një propozim.
- ⦿ Nxiti studentët të përdorin njohuri konceptuale dhe teorike për pyetjet e politikës bashkëkohore, të kryejnë disa hulumtime, të identifikojnë dhe të peshojnë alternativat e mundshme.
- ⦿ I lejon pedagogët të testojnë si nivelet e ulëta ashtu edhe më të larta të fushës së njohjes.
- ⦿ Mund t'u japë studentëve mundësinë të punojnë në një çështje të botës reale që është me interes për ta dhe në bashkëpunim me politikëbërësit në qeveri ose organizata të ndryshme.
- ⦿ Mundëson të studiosh një sfidë të botës reale dhe të prezantosh zgjidhje të mundshme.
- ⦿ Është një formë autentike e të mësuarit: veçanërisht nëse studentët kanë mundësinë për të paraqitur punën e tyre të politikëbërësit.
- ⦿ Puna në një projekt-dokument të politikës mbështet zhvillimin e një sërë aftësish të vlefshme për punësimin e ardhshëm për studentët.

Sfidat e dokumentit të politikës

- ⊗ Dallimet midis një dokumenti politikash dhe një eseje / minikërkimi / studim rasti duhet të sqarohen qartë për studentët.
- ⊗ Ka tendencë të vlerësojë zbatimin e njohurive në një fushë të veçantë sesa gjerësinë e kurrikulës.
- ⊗ Pedagogët duhet të mendojnë sesi t'i krijojnë mundësi studentëve të punojnë së bashku në mënyrë efektive.
- ⊗ Në varësi të natyrës së çështjes, kjo lloj detyre mund të jetë mjaft gjithëpërfshirëse.
- ⊗ Studentët mund të mos jenë mësuar me këtë lloj detyre, kështu që ata do të kenë nevojë për udhëzime të qarta për pritshmëritë; një shpjegim të qartë të kriterëve të vlerësimit.
- ⊗ Studentët mund të kenë nevojë për disa udhëzime sesi të balancojnë punën për dokumentin e politikave kundrejt kriterëve të vlerësimit.

Besueshmëria, vlefshmëria, drejtësia në vlerësimin e dokumentit të politikës

- ⊗ Është e rëndësishme që pedagogu që harton dhe vendos vlerësimin e dokumentit të politikave të përcaktojë qartë rezultatet e synuara.
- ⊗ Duhet pasur parasysh gjithashtu sesi dokumenti i politikave do të vlerësohet përkundrejt formave të tjera të vlerësimit në kurs / program.
- ⊗ Është e dobishme që pedagogët të mendojnë sesi studentët do të përgatiten në mënyrë formale për të punuar për një dokument të politikës dhe cilat aktivitete të strukturuar shtesë mund të jenë pjesë e këtij procesi.
- ⊗ Studentët ka të ngjarë të kenë nevojë për udhëzime për çështje të tilla si: gjatësia e dokumentit të politikave; fushat e përmbajtjes dhe formatimi.
- ⊗ Është e rëndësishme të vendosen kriterë të qarta vlerësimi për studentët.

3. ESEJA

Eseja është një punim i shkurtër akademik. Një ese është një diskutim ose debat specifik për një temë nga një këndvështrim specifik. Një student diskuton temën nga këndi i tij specifik. Eseja është një nga llojet më të përdorura të detyrave për vlerësim. Eseja përdoret veçanërisht kur kërkohet krahasim, analizë, argumentim, vlerësim. Njëpërmjet esesë vlerësohen aftësinë e studentëve për të punuar me burime të shumta.

Llojet e eseve

Eseja narrative

Në një ese narrative, studenti tregon një histori për një përvojë të jetës reale. Ndërsa shkrimi i një tregimi mund të duket i lehtë për t'u bërë, eseja narrative i sfidon studentët të mendojnë dhe të shkruajnë për veten e tyre. Një ese narrative e hartuar mirë do të çojë gjithashtu drejt nxjerrjes së një përfundimi ose bërjes së një deklaratë personale.

Eseja përshkruese

Një ese përshkruese përshkruan një person, vend, objekt, apo edhe memorie me rëndësi të veçantë. Sidoqoftë, kjo lloj eseje nuk është përshkrim për hir të përshkrimit. Eseja përshkruese përqipet të komunikojë një kuptim më të thellë përmes përshkrimit.

Eseja ekspozuese

Eseja ekspozuese është një shkrim informues që paraqet një analizë të ekuilibruar të një teme. Në një ese ekspozuese, studenti shpjegon ose përcakton një temë, duke përdorur fakte, statistika dhe shembuj. Shkrimi ekspozues përfshin një gamë të gjerë të variacioneve të eseve, të tilla si eseja e krahasimit dhe kontrastit, eseja e shkakut dhe efektit. Për shkak se eseja ekspozuese bazohet në fakte dhe jo në ndjenja personale, studenti nuk shkruan në vetën e parë.

Eseja bindëse

Qëllimi i esesë bindëse është të bindë lexuesin të pranojë këndvështrimin ose rekomandimin e studentit. Studenti duhet të ndërtojë një çështje duke përdorur fakte dhe logjikë, si dhe shembuj, mendim eksperti dhe arsyetim të bazuar. Studenti duhet të paraqesë të gjitha anët e argumentit, por duhet të jetë në gjendje të komunikojë qartë dhe pa ekuivoke pse një pozicion i caktuar është i saktë. Një ese bindëse ka për qëllim të bindë lexuesit të bëjnë gjëra ose të mos bëjnë gjëra të caktuara. Qëllimi është të krijojë bindje për të bërë gjëra të caktuara ose për të ndërmarrë veprime.

Eseja përkufizuese

Është një lloj eseje që përcakton një term, një koncept ose një ide. Dallimi, megjithatë, i një përcaktimi të thjeshtë nga një ese përkufizuese është se një përkufizim i thjeshtë është një përkufizim i mirëfilltë, ndërsa një ese përkufizuese përfshin të gjitha përcaktimet konotative dhe denotative të një termi. Një ese përkufizuese prezanton termin, konceptin ose idenë e përcaktuar, paraqet informacion të qartë dhe specifik për termin dhe përdor shembuj për ta sqaruar atë. Fjalët, idetë dhe konceptet kanë kuptime të ndryshme konotative në kontekste të ndryshme. Një koncept në një tekst mund të jetë krejt i ndryshëm nga i njëjti koncept i përdorur në një tekst tjetër. Për të shpjeguar në detaje të hollësishme, përkufizimet e ndryshme

janë mbledhur dhe analizuar. Përkufizimet gjithashtu bazohen në strukturën dhe analizën, si dhe funksionet. Kur këto përkufizime diskutohen sipas roleve të tyre në kontekste të ndryshme, kemi ese përkufizuese. Një përkufizim është vetëm një thënie e thjeshtë për një term, por një ese përkufizuese është një diskutim i disa përkufizimeve të të njëjtit term. Një ese përkufizuese ka tendencë të përcaktojë një term dhe të zgjidhë një polemikë. Eseja përkufizuese paraqet dallime midis përkufizimeve të ndryshme të një termi. Ajo paraqet një pamje të plotë të përdorimeve të ndryshme të të njëjtit term në kontekste të ndryshme, duke i bërë analizë për të gjitha interpretimet kontekstuale.

Eseja argumentuese

Një ese argumentuese është një lloj eseje që paraqet argumente për të dy palët e një çështjeje. Mund të jetë që të dy palët të paraqiten në mënyrë të barabartë, ose mund të jetë që njëra palë të paraqitet më me forcë se tjetra. Sidoqoftë, një ese argumentuese synon t'i paraqesë dy anët e medaljes dhe i lë lexuesit të vendosë. Një ese bindëse dallon nga një ese argumentuese se eseja bindëse synon t'i bëjë lexuesit të bëjnë gjëra të caktuara dhe prandaj paraqet argumente vetëm për një aspekt të çështjes.

Eseja analitike

Një ese analitike bën një analizë të një koncepti, një ideje, procesi. Eseja analitike nënkupton zbërthimin e diçkaje në pjesë, ose diskutimin e diçkaje në atë mënyrë që të bëhet një ndarje në pjesë e tërësisë. Qëllimi i saj kryesor është të përmirësojë të kuptuarin. Eseja analitike ndryshon nga llojet e tjera të eseve në atë që qëllimi kryesor është të shpjegojë diçka pak nga pak për të rritur të kuptuarit. Në të shumtën e rasteve, një ese analitike shkruhet për analizën e një teksti, të një procesi, ose të një ideje. Sidoqoftë, në letërsi është një analizë kritike e disa teksteve letrare, e cila bëhet për të forcuar të kuptuarit e saj.

Një analizë mund të bëhet përmes një procesi, përkufizimi, klasifikimi dhe ndarjeje, ose krahasimi dhe kontrasti. Gjëja ose ideja është e ndarë në disa pjesë, përmes klasifikimit dhe pastaj analizohet. Një proces është i ndarë në disa hapa për analiza. Esetë analitike i bëjnë lexuesit të vetëdijshëm për hollësitë e gjërave.

Eseja kritike

Një ese kritike është një formë e shkrimit akademik që analizon, interpreton dhe / ose vlerëson një tekst. Eseja kritike analizon dhe vlerëson kuptimin dhe rëndësinë e një teksti, në vend që të gjykojnë për përmbajtjen ose cilësinë e tij. Një ese kritike synon të përçojë kuptime specifike të një teksti tek audiencia specifike.

Eseja e procesit

Siç sugjeron emri, kjo lloj eseje shpjegon një proces të diçkaje. Kjo ese shpesh shkruhet sipas rendit kronologjik, ose për të treguar proceset hap pas hapi. Ajo shkruhet në mënyrë përshkuese. Një ese procesi i jep lexuesit një kuptim të plotë të procesit se ç' duhet bërë ose krijuar.

Eseja për zgjidhjen e problemeve

Në shkrimin e detyrave që përqendrohen në çështje, politika ose dukuri, shpesh kërkohet të propozohen zgjidhje të mundshme për problemet e identifikueshme. Kjo lloj eseje kërkon vlerësim në dy nivele. Para së gjithash, kërkon që të përdoret vlerësimi në mënyrë që të përcaktohet se ekziston një problem legjitim. Dhe së dyti, kërkon që të paraqitet më shumë se një politikë ose zgjidhje dhe të përcaktohet se cila zgjidhje do të jetë më e realizueshme, më e zbatueshme ose më e efektshme, duke pasur parasysh atë problem.

Struktura e esesë

- ⦿ Hyrja, e cila paraqet informacionin bazë ose tezën kryesore.
- ⦿ Pjesa kryesore, e cila përmban opinionin kryesor, shpjegimin, shembullin, detajet mbështetëse, kundërargumentet
- ⦿ Përfundimi, që përmban riformulimin e tezës, përmbledhje të pikave dhe shënime përmbyllëse.

Avantazhet e esesë

- ⦿ Eseja mundëson vlerësimin e atësive të studentit në nivelet më të larta të fushës së njohjes, si të menduarit kritik, zhvillimin e argumenteve, të menduarit e pavarur, gjykimin.
- ⦿ Performanca e studentit nuk kushtëzohet nga koha.
- ⦿ Studentët mund të konsultohen me burime të ndryshme literature kur shkruajnë një ese.
- ⦿ Eseja kërkon që studentët të prezantojnë mendimin e tyre, ndërsa përdorin gjuhë profesionale dhe teknike.
- ⦿ Disa nga fazat e zhvillimit të një eseje mund të përdoren si forma të vlerësimit në vetvete (p.sh. bibliografia me shënime, plani i esesë), për të ndihmuar në monitorimin e përparimit të studentëve.

Sfidat e esesë

- ⦿ Eseja në mënyrë të pashmangshme përqendrohet në një pjesë të materialit të mbuluar nga kursi.
- ⦿ Nëse provimet përdoren për vlerësimin përmbledhës, mund të jetë e vështirë për studentët të shohin ndonjë përfitim të transferueshëm nga eseja formuese.
- ⦿ Eseja krijon mundësi për sjellje akademike të paautorizuara, prandaj kërkohet të zbatohen rregullat e ndershmërisë akademike.
- ⦿ Kapaciteti i një studenti për të demonstruar aftësitë e tij në një ese mund të ndikohet nga përvoja e tij e mëparshme arsimore.
- ⦿ Vlerësimi i esëve në mënyrë objektive shtron problemin për përcaktimin e kritereve të vlerësimit.

Besueshmëria, vlefshmëria, drejtësia në vlerësimin e esesë

- ⊗ Pyetjet e esesë shpesh hartohen në ekipe, gjë që ndihmon të vendoset besueshmëri që në fillim të procesit të vlerësimit.
- ⊗ Përcaktimi i kërkesave të qarta për shkrimin e esesë i mundësojnë studentëve të orientojnë përgjigjen në pikat e kërkuara.
- ⊗ Kriteret duhet të përcaktohen paraprakisht dhe të ndahen me studentët.
- ⊗ Përcaktimi i llojit dhe formatit të esesë ndihmon vlefshmërinë e punimit dhe vlerësimin e drejtë.
- ⊗ Ofrimi i modeleve të mira të esëve për studentët i ndihmon ata të përgatisin punime të mira.
- ⊗ Ndryshimi i titujve të esëve çdo vit parandalon përdorimin e detyrave të përgatitura nga studentët e viteve të mëparshme.
- ⊗ Pedagogu mund të kërkojë që studentët të punojnë me burime mjaft specifike, për shembull një artikull të veçantë akademik, histori pacientësh, dokumente biznesi pasi kjo zvogëlon mundësinë e përdorimit të esëve të mëparshme.
- ⊗ Kërkesa për një element të shkurtër shtesë që demonstroi të kuptuarit e studentëve për përmbajtjen e tij, përmes një arsytimi se cilat burime janë përdorur, ndihmon në ruajtjen e praktikës së mirë akademike pasi studentët kanë për detyrë të justifikojnë qasjen e tyre sesa thjesht të prodhojnë përgjigje.
- ⊗ Kërkesa ndaj studentëve për të treguar plane ose bibliografi me shënime përpara paraqitjes përfundimtare të esesë, gjithashtu mund të kufizojnë sjelljet e paautorizuara.

4. POSTERI

Posteri shfaq tekstin dhe informacionin vizual në një faqe të vetme, tabelë ose ekran. Posteri u ofron studentëve mundësinë për të paraqitur punën akademike të paraqitur vizualisht, në një hapësirë të caktuar dhe në mënyrë koncize. Posterat mund të ekspozohen në medime dixhitale. Ky lloj punimi për vlerësim, mund të jetë një përvojë e re për studentët dhe prandaj ata familjarizohen paraprakisht për përgatitën e posterit.

Avantazhet e posterit

- ⦿ Posteri u ofron studentëve mundësi për të demonstruar aftësitë krijuese, i motivon në zhvillimin e ideve dhe artikullimit të gjetjet përmes prodhimit të punës origjinale.
- ⦿ Mund të kombinohet me aktivitete të tjera, të tilla si prezantime, raporte, ese, projekte ose konferenca studentore.
- ⦿ Mund të përdoret për të vlerësuar aftësitë e zbatimit, analizës, vlerësimit, krijimit dhe komunikimit.
- ⦿ Ofron mundësinë për të komunikuar me një audiencë më të gjerë. Studentët mund të prezantojnë me lehtësi punën e tyre për audiencë të interesuara përmes një ekspozite publike virtuale.
- ⦿ Krijon mundësi për bashkëpunim dhe rishikim nga kolegët. Studentët mund të krijojnë postera bashkërisht dhe ata mund të rishikojnë punën e njëri-tjetrit.
- ⦿ Ofron një përvojë autentike.

Sfidat e posterave

- ⦿ Kërkohej që studentët të krijojnë postera që përmbushin synime akademike dhe të jenë vizualisht tërheqës.
- ⦿ Studentët mund të mos kenë përvojë paraprake duke përdorur materiale të bazuara në imazhe për qëllime akademike.
- ⦿ Ky format mund të kërkojë më shumë mbështetje, fillimisht, nga pedagogu për t'i ndihmuar studentët të kuptojnë se çfarë pritët.
- ⦿ Nevojë e mundshme për udhëzime / mbështetje teknike për studentët dhe pedagogët.

Besueshmëria, vlefshmëria, drejtësia në vlerësimin e posterave

- ⦿ Përcaktohen standardet për formatin e posterit. Nëse standardet e dëshiruara janë artikulluar dhe ilustruar, dhe studentët kuptojnë sesi mund t'i arrijnë ato përmes tekstit, imazhit, modelimit, paraqitjes, referimit, etj., atëherë ka më shumë të ngjarë të arrijnë një nivel komunikimi të mjaftueshëm akademik dhe krijues.
- ⦿ Paraqitja e kërkesave për origjinalitet dhe integritet shmangin plagjiaturën.
- ⦿ Kur është e mundur, vlen të sigurohen postera model.
- ⦿ Përcaktohen kriteret e qarta të vlerësimit.

5. DOSJA ELEKTRONIKE

Në mënyrë tipike, një dosje elektronike është një koleksion i punimeve të studentëve që organizohet dhe prezantohet elektronikisht për të dëshmuar rezultate të të nxënës gjatë një periudhe kohe.

Një dosje është një koleksion i artefakteve të tilla elektronike, si punime të llojeve të ndryshme në tekst, punime elektronike, postera, video, imazhe të prodhuara në faza të ndryshme përgjatë një kursi studimi.

Dosjet mundësojnë të nxënë më të thelluar për studentët, dhe pedagogët fitojnë një njohje më të mirë për nivelin e njohurive dhe të aftësive të studentëve. Dosja elektronike demonstroi aftësitë e studentit dhe vetëshprehjen e tij. Dosja elektronike, ashtu si dosja tradicionale mundëson reflektimin e studentit për të nxënë e tij.

Dosja elektronike mund të ndërtohet duke përdorur një larmi mjetesh të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Këto mjete lejojnë studentët të shkruajnë dokumente dhe të ngarkojnë foto, audio dhe video. E gjithë përmbajtja, nëse është e nevojshme, mund të shpërndahet në mjetet e tjera të mediave. Web faqet themelore, blogjet dhe Wikis gjithashtu mund të përdoren si dosje elektronike. Dosja elektronike është një formë që mundëson paraqitjen e një përmbajtjeje të larmishme. Dosja elektronike, për shembull, mund të përmbajë filma, audio, prezantime, tekst dhe animacione.

Përdorimi i dosjes elektronike mundëson vlerësimin e aftësive të zbatimit, analizës, vlerësimit dhe krijimit. Studentët priten të krijojnë, kompozojnë, konstruktojnë, hartojnë, gjenerojnë, madje edhe të shpikin dhe të prodhojnë.

Avantazhet e dosjes elektronike

- ⊗ Një dosje mund të përdoret për të dokumentuar sesi një student në të vërtetë kryen një detyrë.
- ⊗ Hartimi i një dosjeje mund t'u japë studentëve përvojë në dokumentimin dhe prezantimin e arritjeve të tyre - një aftësi e rëndësishme komunikimi.
- ⊗ Një dosje mund të sigurojë prova të aftësive për botën reale që studentëve mund t'u duhen për studim ose punësim në të ardhmen.
- ⊗ Studentët mund ta shohin vlerësimin nëpërmjet dosjes si një formë të efektshme të vlerësimit, pasi dosja përfaqëson punën e prodhuar gjatë një periudhe kohore të caktuar dhe kërkon një gamë më të madhe aftësish.
- ⊗ Përdorimi i dosjes shërben edhe për qëllime të vlerësimit formues duke e ndihmuar studentin sesi të përmirësojë aftësitë e tij.

Sfidat e dosjes elektronike

- ⊗ Prodhimi i një dosjeje për vlerësim kërkon që studentët të investojnë një sasi të konsiderueshme kohe. Vlerësimi i dosjeve mund të marrë kohë, veçanërisht nëse ato janë të parashikuara për të paraqitur dëshmi të aftësive komplekse të fituara, përveç njohurive.
- ⊗ Formati i dosjes përshkruhet në detaje dhe u komunikohet studentëve në fillim të kursit të studimit si dhe para kryerjes së detyrës.
- ⊗ Pedagogu mund të ketë nevojë të mbikëqyrë procesin më nga afër, që të sigurohet se studentët janë duke u angazhuar vazhdimisht me prodhimin e dosjes.
- ⊗ Kur sistemet në internet përdoren për të mbështetur prodhimin e dosjës, studentët mund të shqetësohen për aftësitë e tyre teknike dhe / ose besueshmërinë e sistemeve të përdorura.

Besueshmëria, vlefshmëria, drejtësia në vlerësimin e dosjeve

- ⊗ Duke pasur parasysh fleksibilitetin e ofruar për dosjen, është thelbësore që kërkesat të lidhen në mënyrë të qartë me rezultatet e synuara të të nxënit. Këto rezultate duhet të operacionalizohen si në aspektin e kriterëve ashtu edhe të standardeve.
- ⊗ Idealisht, kriteret e vlerësimit duhet të përfshijnë aftësitë e parashikuara të rezultateve të të nxënit.
- ⊗ Më pas studentëve u kërkohet të shkruajnë argumente, duke përshkruar në mënyrë të qartë sesi ata besojnë se puna e tyre siguron dëshmi se ata kanë përmbushur kriteret ose kanë arritur rezultatet e të nxënit.

D. UDHËZIM PËR ZHVILLIMIN E ORËVE LABORATORIKE, PRAKTIKUMEVE DHE PRAKTIKAVE MËSIMORE VIRTUALE

Zhvillimi i orëve të laboratoreve në mësimin në distancë

Përshtatja e komponentëve laboratorikë nga mënyra tradicionale e veprimtarisë në laboratorë realë në një mjedis virtual është sfiduese. Në kushtet e mësimit në distancë, duke mbajtur parasysh faktin që studentët kanë njohuri dhe aftësi për komponentin laboratorik nga vitet e mëparshme dhe semestri i parë i këtij viti akademik, veprimtaria laboratorike mundësohet nëpërmjet veprimtarive si më poshtë.

- a. *Veprimtari laboratorike online nëpërmjet internetit.* Shumë veprimtari laboratorike kërkojnë që studentët të njihen me procedura të caktuara. Në raste të tilla, do të mbahet parasysh që përvoja laboratorike të mund të fitohet online nëpërmjet demonstrimeve me video të procedurave të caktuara laboratorike, të teknikave, të simulimeve në internet, të analizës së të dhënave dhe punë të tjera para ose post-laboratori.
- b. *Investigim i laboratorëve virtualë.* Burimet në internet dhe mjetet virtuale mund të ndihmojnë për të fituar përvojën laboratorike duke investiguar në internet funksionimin e laboratorëve, të përgatitjes së pajisjeve laboratorike, të procedurave laboratorike, të procedurave të kryerjes së analizave laboratorike.
- c. *Sigurimi i të dhënave të papërpunuara për analiza.* Në rastet kur laboratori përfshin edhe mbledhjen e të dhënave dhe analizën e tyre, do të demonstron virtualisht nëpërmjet videove dhe simulimeve sesi mund të mblidhen të dhënat, dhe më pas do të ofrohen disa grupe të papërpunuara të të dhënave për studentët që t'i analizojnë.

Titullari i lëndës në bashkëpunim me pedagogun që zhvillon orët e laboratorëve përzgjedhin veprimtarinë/veprimtaritë, përgatisin udhëzuesin praktik për procedurën e veprimtarive laboratorike dhe kriteret e vlerësimit dhe ua vënë në dispozicion studentëve. Vlerësimi i aftësive laboratorike do të kryhet nëpërmjet detyrave të tipit klinik në trajtën e studimit të rastit, të analizës së evidencës, të simulimit të procedurave laboratorike ose të dosjes laboratorike.

Zhvillimi i praktikumeve dhe praktikave profesionale në mësimin në distancë

Një nga sfidat më të mëdha të mësimit në distancë është kryerja e praktikumeve dhe praktikave profesionale. Në kushtet e mësimit në distancë, duke mbajtur parasysh

faktin që studentët kanë fituar disa aftësi profesionale nga vitet e mëparshme dhe semestri i parë i këtij viti akademik, praktikumi dhe praktika profesionale kryhet nëpërmjet veprimtarive si më poshtë.

- a. *Krijim i dosjes profesionale me tematikë të caktuar.* Dosja përmban dokumente të politikave, udhëzimeve; evidenca me të dhëna; video; paketë me formularë; paketë me intervista, bilance, reklama, buletine, etj. Dosja shoqërohet me një analizë dhe rekomandim për përdorimin e materialeve të përzgjedhura.
- b. *Kërkim në internet për platforma elektronike tematike sipas fushës së praktikës.* Përzgjidhen dy platforma, bëhet analiza e tyre dhe jepen rekomandime për përdorimin e tyre.
- c. *Përgatitje e paketave me mjete, modele, platforma, dokumente, punime, instrumente sipas një tematike të caktuar nga fusha e praktikës për të vënë në zbatim njohuritë e fituara në fushën e studimit për të cilën organizohet praktika.*
- d. *Vëzhgim i veprimtarive virtuale të organizatave të ndryshme, të mësimëve, të publikimeve të fushës.* Përgatitet ditari i vëzhgimit dhe një raport reflektimi për vëzhgimin e kryer në platforma ose programe virtuale.
- e. *Simulim i veprimtarive online, përgatitje e videove me punonjës të organizatave të ndryshme, zhvillim i seancave mësimore me fëmijë online, përgatitje e platformave digjitale.*

Në rastin e praktikumit, pedagogu që zhvillon praktikumin përzgjedh veprimtarinë/veprimtaritë, përgatit udhëzuesin praktik për procedurën e veprimtarive të praktikumit dhe kriteret e vlerësimit dhe ia vë në dispozicion studentëve. Vlerësimi i aftësive praktike do të kryhet në bazë të cilësisë së produkteve të përgatitura, të analizës së punimeve, të analizës së evidencës, të simulimit të procedurave praktike ose të dosjes profesionale.

Në rastin e praktikës profesionale, departamenti që mbulon praktikën profesionale miraton llojin e veprimtarive, procedurat për kryerjen e veprimtarive, kriteret për përgatitjen e punimeve dhe kriteret për vlerësimin, duke mbajtur parasysh qëllimet e praktikës.

E. POLITIKA E VLERËSIMIT NË DISTANCË NË UST

1. PARIME TË VLERËSIMIT NË DISTANCË

- a. Vlerësimi bazohet në rezultatet e pritshme të të nxënit të përcaktuara për secilën lëndë, të modifikuara në përputhje me mësimin në distancë.
- b. Përzgjedhja e formës/formave të vlerësimit bëhet duke mbajtur parasysh specifikat e lëndës mësimore, qëllimin e vlerësimit, mundësitë e studentit.
- c. Detyrat për vlerësim ndërtohen bazuar në taksonominë e rishikuar të Bloom për objektivat në fushën e njohjes. Shih tabela 1 në këtë udhëzim.
- d. Kombinohet vlerësimi formues me vlerësimin përmbledhës.
- e. *Vlerësimi formues* si vlerësim për të nxënit, është vlerësim i një shkalle të vogël, është afatshkurtër dhe jep informacion për progresin e të nxënit të studentëve, përdoret për të përmirësuar të nxënit, nxit fidbekun për progresin e të nxënit, nxit reflektimin aktiv, krijon evidencë për vlerësimin përmbledhës. Pedagogët do të përdorin vlerësimin formues për të krijuar evidencën sesi studentët po përparojnë në të nxënit e tyre dhe do t'u japin fidbek studentëve për të mbështetur të nxënit e tyre.
- f. *Vlerësimi përmbledhës*, si një vlerësim i të nxënit, ka për qëllim sigurimin e informatave mbi arritjen e rezultateve të të nxënit të lëndës, në fund të periudhave mësimore dhe në fund të vitit akademik. Ky lloj vlerësimi duhet të marrë gjithësi parasysh edhe informatat e mbledhura nga vlerësimi formues.
- g. Kombinohet vlerësimi me vetëvlerësimin.
- h. Vlerësimi autentik përdoret për të vlerësuar aftësitë e studentëve për të zgjidhur detyra nga jeta reale.
- i. Zbatohet transparencja e kriterëve të vlerësimit për studentët.
- j. Përcaktohen standardet e formateve për detyrat dhe kriteret e vlerësimit dhe i bëhen të ditura studentëve.
- k. Respektohet ndershmëria akademike.
- l. Respektimi i ndershmërisë akademike është një parim i rëndësishëm gjatë mësimin në distancë. Kërkohet që format e përdorura të vlerësimit të minimizojnë mundësinë e kopjimit, mashtrimit dhe të bashkëpunimit të palejuar ndërmjet studentëve.
- m. Tregohet kujdes për kategoritë vulnerabël të studentëve.
- n. Studentët të cilët, si rezultat i sëmundjes, karantinës, ose ndonjë situatë tjetër personale ose familjare që është rrjedhojë e pandeminë e COVID-19, nuk janë në gjendje të plotësojnë të gjitha detyrimet e lëndëve dhe të provohen në datat e përcaktuara do të mbështeten duke iu dhënë një mundësi e dytë.

2. FORMA DHE PROCEDURA TË VLERËSIMIT NË DISTANCË PËR ARRITJET LËNDORE DHE DETYRIMET PËRMBYLLËSE

a. PROVIM ME GOJË ONLINE PËR 15 MINUTA PËR ÇDO STUDENT NËPËRMJET VIDEOKONFERENCËS NË NJË PLATFORMË DIGJITALE

Organizimi dhe drejtimi i një provimi me gojë

- ⊗ Studentët informohen paraprakisht nga pedagogët për llojin e pyetjeve dhe procedurën e zhvillimit të provimit online.
- ⊗ Studentët informohen për grafikun e provimit duke përcaktuar radhën dhe orën e thirrjes në provim online.
- ⊗ Studentët informohen se provimi me gojë online do të regjistrohet.
- ⊗ Pyetjet janë të parapërgatitura dhe kanë numra. Studentët zgjedhin sipas numrave.
- ⊗ Provimi kufizohet deri në tre pyetje.
- ⊗ Pyetjet janë të hapura që t'i mundësojnë studentëve të japin përgjigje të plota dhe të qarta.
- ⊗ Pyetje ndërtohen të tilla që të kërkojnë të zbulojnë çfarë kanë nxënë studentët, sesa çfarë ju është mësuar atyre.
- ⊗ Pyetjet kërkojnë që studentët të përdorin njohuritë e tyre si dhe t'i riinterpretojnë ato në mënyrë inteligjente.
- ⊗ Studentët informohen paraprakisht për kriteret e vlerësimit.

b. TEST ME SHKRIM ME PYETJE TË TIPIT OBJEKTIV DHE SUBJEKTIV NËPËRMJET NJË PLATFORME DIGJITALE QË MUNDËSON PËRDORIMIN E TESTEVE

- ⊗ Testi me shkrim online zhvillohet duke përdorur platformën digjitale të përzgjedhur nga departamenti.
- ⊗ Testi me shkrim online mund të përmbajë
 - a. pyetje të tipit objektiv me alternativa të shumta
 - b. pyetje të tipit me kombinime
 - c. pyetje të tipit me plotësim
 - d. pyetje të tipit subjektiv me përgjigje të kufizuara
 - e. pyetje të tipit subjektiv me përgjigje të zgjeruara
 - f. pyetje të tipit objektiv dhe të tipit subjektiv
- ⊗ Testi me shkrim online kryhet brenda një kohë të caktuar
- ⊗ Vlerësimi i testit me shkrim online bëhet automatik

c. PROVIMI I KRYER NGA SHTËPIA

- ⊗ Provimi i kryer nga shtëpia është një formë e provimit me libra të hapura, por në këtë rast kryhet në kushtet e shtëpisë. Provimi me libra të hapura nga shtëpia nuk mat kujtesën. Ky lloj provimi përdoret për të matur dhe vlerësuar aftësitë për të gjetur informacion, për të analizuar, për të zgjidhur një problem, për të ideuar një problem, për të zbatuar njohuri në një situatë të re, për të krijuar. Pyetjet ndërtohen të tilla që kërkojnë zbatim të njohurive dhe kërkojnë të zgjidhet një problem, të paraqitet një zgjidhje. Në këtë lloj provimi ka rëndësi përzgjedhja dhe përdorimi i informacionit të duhur sipas çështjes së dhënë.
- ⊗ Për këtë lloj detyre të kryer online, zakonisht parashikohet 30-60 minuta më shumë se koha e parashikuar në provimin me libra të hapura në kampus. Kjo kohë shtesë parashikohet për veprimet e hyrjes në platformë të shkarkimit dhe të ngarkimit të materialit, të gjetjes së burimeve në internet.
- ⊗ Kohëzgjatja e provimit të kryer nga shtëpia do të jetë 2-3 orë.
- ⊗ Për këtë lloj provimi mund të përdoret një nga këto lloje detyrash:
 - ⊗ Studim rasti
 - ⊗ Ese
 - ⊗ Projekt
 - ⊗ Analizë klinike, dokumenti, evidence, të dhënash
 - ⊗ Përgatitje platforme
 - ⊗ Përgatitje modeli
 - ⊗ Poster
- ⊗ Provimi i kryer nga shtëpia mat:
 - a. aftësinë për të përdorur burime jashtë klase
 - b. aftësinë për t'u përqendruar në një fushë qendrore
 - c. aftësinë për të prodhuar një ekstrakt nga një ose disa burime
 - d. aftësinë për të paraqitur një mendim profesional
 - e. aftësinë për të argumentuar
 - f. aftësinë për të gjykuar e vlerësuar
 - g. aftësinë për të krijuar
 - h. aftësinë për të organizuar përgjigjen
- ⊗ Për secilën detyrë paraqiten kërkesat e formatit dhe kriteret e vlerësimit.
- ⊗ Për provimin nga shtëpia studenti ndjek udhëzuesin e procedurës së provimit të paraqitur nga pedagogu i lëndës.

Avantazhet e provimit të kryer nga shtëpia

- ⊗ Periudha kohore dhe mundësia për të përdorur material, mund t'i lejojë studentët të demonstrojnë më mirë njohuritë, aftësitë dhe përdorimin e burimeve.
- ⊗ Nëse rezultatet e të nxënit të kursit theksojnë aftësi njohëse të rendit më të lartë (argument, aplikim, krahasim, kritikë etj.) dhe përdorimin e burimeve, një provim nga shtëpia mund të lejojë një vlerësim më autentik.
- ⊗ Për studentët, një provim nga shtëpia mund të jetë më pak stresues sesa një provim tradicional.

Sfidat e provimit të kryer nga shtëpia

- ⊗ Studentët duhet të shmangim plagjiaturën. Në provimin me libra të hapura nga shtëpia duke qenë se studentët i kanë burimet e informacionit në dispozicion, nuk kërkohet të riprodhohet informacioni, por duhet të interpretohet, të zbatohet në përputhje me pyetjen e dhënë.
- ⊗ Duke qenë se studentët mund të kenë në dispozicion shumë burime literature, kërkohet që të përzgjedhin me kujdes vetëm ato më të përshtatshmet dhe të veprojnë shpejt.
- ⊗ Studentët duhet të sigurojnë hapësirën e tyre të punës dhe pajisjet kompjuterike.
- ⊗ Mbështetja e duhur duhet të jetë e disponueshme, si teknike, ashtu edhe për sqarime.

Besueshmëria, vlefshmëria, drejtësia në vlerësimin e provimit të kryer nga shtëpia

- ⊗ Pyetjet duhet të hartohen për të kërkuar veprimtari të rendit më të lartë nga studentët.
- ⊗ Rezultatet e synuara të të nxënit të një lënde shpesh shkruhen të tilla që pasqyrojnë atë që studentët do të kenë mësuar deri në fund të kursit.
- ⊗ Kriteret duhet të përcaktohen paraprakisht dhe të ndahen me studentët.
- ⊗ Udhëzimet me shkrim duhet të përgatiten me kujdes në mënyrë që të minimizojnë stresin dhe pyetjet e studentëve gjatë periudhës së vlerësimit. Këto duhet të përfshijnë: llogaritjen e fjalëve; sistemet e preferuara të referimit dhe politikën për paraqitjet me vonësë.

d. DOSJE ELEKTRONIKE E PUNIMEVE TË KURSIT

- ⊗ Dosja elektronike e punimeve përmban një sërë punimesh, por për qëllime të vlerësimit paraqiten dy punime që mund të jenë:
 - ⊗ ese,
 - ⊗ studim rasti,
 - ⊗ projekt,
 - ⊗ modele,
 - ⊗ poster,
 - ⊗ dokument politikash,
 - ⊗ video,
 - ⊗ analizë evidencash,
 - ⊗ raporte,
 - ⊗ analizë klinike.

- ⊗ Për secilin lloj punimi paraqiten stadardet e formatit dhe kriteret e vlerësimit.
- ⊗ Punimet kryhen gjatë periudhës së mësimit.
- ⊗ Studenti ndjek udhëzuesin e procedurës së dosjes elektronike të paraqitur nga pedagogu i lëndës.
- ⊗ Vlerësimi bazohet në pikët e fituara nga punimet e paraqitura.

3. TAKSONOMIA E BLOOMIT: FORMA TË DETYRAVE PËR VLERËSIM NË FUSHËN E NJOHJES

	Të mbajturit mend	Të kuptuarit	Zbatimi	Analiza	Vlerësimi	Krijimi
Përshkrimi i niveleve	Eksponon të mbajturit mend të materialit të mësuar më parë duke kujtuar fakte, terma, koncepte themelore dhe duke dhënë përgjigje.	Demonstron të kuptuarit e fakteve dhe ideve duke organizuar, krahasuar, transformuar, interpretuar, përshkruar dhe duke deklaruar idetë kryesore.	Zgjidh problemet në situata të reja duke përdorur në një mënyrë tjetër njohuri, fakte, teknika dhe rregulla të përvetësuara më parë.	Shqyrton dhe ndan informacion në pjesë duke identifikuar motivet apo shkaqet. Nxjerr përfundime dhe gjen prova për të mbështetur përgjithësimet.	Prezanton dhe mbron opinione duke bërë gjykime rreth informacionit, vlefshmërisë së ideve, apo cilësisë së punës bazuar në një sërë kriteresh.	Formaton informacionin në një mënyrë të ndryshme duke kombinuar elementet në një model të ri ose duke propozuar zgjidhje alternative.
Forma të vlerësimit online	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Teste objektive me përgjigje alternative, ☞ me alternativa të shumta, ☞ me përgjigje të shkurtër ☞ me plotësim 	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Simulime ☞ Animacione ☞ Demonstrim 	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Teste objektive me alternativa të shumta ☞ Ese ☞ Simulime ☞ Studim rasti ☞ Zgjidhje problemi ☞ Laborator virtual ☞ Pacient virtual 	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Teste objektive me alternativa të shumta ☞ Ese ☞ Projekte ☞ Dosje me punime ☞ Simulime ☞ Prezantime ☞ Analiza evidencash ☞ Analizë të dhënash ☞ Stdutim rasti ☞ Detyrë e kryer me libra të hapura 	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Teste objektive me alternativa të shumta ☞ Ese, ☞ Projekte ☞ Dosje me punime ☞ Simulime ☞ Prezantime ☞ Analiza evidencash ☞ Analizë të dhënash ☞ Stdutim rasti ☞ Detyrë e kryer me libra të hapura 	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Teste objektive me alternativa të shumta ☞ Ese ☞ Projekte ☞ Dosje me punime ☞ Simulime ☞ Prezantime ☞ Analiza evidencash ☞ Analizë të dhënash ☞ Stdutim rasti ☞ Detyrë e kryer me libra të hapura

II. KËSHILLA PËR TË ORGANIZUAR TË MËSUARIT NË DISTANCË NË KUSHTET E SHTËPISË

1. Përfshihuni në mësim

- Kontrolloni vazhdimisht postën elektronike dhe platformën digjitale për njoftimet më të fundit për mësimin.
- Paraqituni në orarin e caktuar për mësimin sinkron në platfoirmën digjitale të caktuar.
- Qëndroni pranë një vendi të përshtatshëm, mbani një fletore për shënimet dhe një stilolaps, si dhe përpiquni të shmangni në minimum shpërnqëndrimet.
- Mbani shënime kur ndiqni leksionin me audio, video, ose me mënyra të tjera prezantimi online.
- Fillimisht, dëgjoni dhe më pas pyesni për paqartësira.

2. Bashkërendohuni me grupet e komunikimit

- Për këtë ka disa programe si Skype, apo Whatsapp, Messenger që mund t'i shkarkoni falas dhe të cilat mundësojnë bashkërendimin e komunikimit me grupin përmes videos.
- Përdorimi i këtyre programeve për të krijuar grupet e studimit me kolegët e kursit ndihmon që të ndani informacion, të diskutoni, të ndani ide, të kryeni detyra në grup, të ndani përvoja, të analizoni tekste, evidencë së bashku dhe të shkëmbeni përvoja për studimin në distancë.
- Grupet e komunikimit ndihmojnë në rritjen e lidhjeve sociale për të mos u ndier tejet të izoluar ndërsa studioni vetëm.
- Planifikoni paraprakisht atë që do të diskutoni dhe provoni të përqendrohëni tek tema që diskutimi të jetë i frytshëm dhe mos u shqetësoni qoftë edhe në se flisni për gjëra të tjera.

3. Mbani kontakt me lektorët

- Ndoshta nuk do të keni mundësi ta shihni lektorët gjatë orëve të mësimin në distancë, sidomos nëse mësimi është asinkron, por ju duhet të mbani kontakte me ta rregullisht.
- Ndoshta një e-mail një herë në javë, apo edhe pas disa ditëve do të përcaktonte ecurinë e kurseve. Por, edhe nëse jeni në ankth apo jeni i stresuar, komunikoni me zyrën e Këshillimit të Karrierës e cila do t'ju ndihmonte për të lehtësuar problemet që mund të keni.
- Gjithashtu kini parasysh të kontaktoni lektorët dhe drejtuesit e seminareve për çështje për të cilat keni nevojë të konsultoheni.
- Jini të duruar ndërsa prisni përgjigje. Lektorët ndoshta është nën trysni të madhe me përgatitjen e leksioneve elektronike, ndaj jepuni kohë që më pas të merren me ju.

4. Siguroni mjetet e duhura për studim

- Të mësuarit në distancë kërkon një kompjuter funksional dhe lidhje të mirë interneti.
- Përpiquni të siguroni kompjuter, telefon inteligjent, tablet.
- Siguroni mjetet e duhura kancelarike (fletore shënimi, stilolapsa, shënuesat) dhe librat apo artikujt e duhur për të studiuar, printime apo botime digjitale.

5. Krijoni këndin e studimit në shtëpi

- ☉ Nëse jeni mësuar të studioni në bibliotekën e UST, ndoshta kjo sjell vështirësi gjatë tranzicionit të studimit nga shtëpia për një kohë të gjatë, por do t'ju duhet të përshtateni.
- ☉ Përcaktoni vendin ku mund të uleni dhe punoni.
- ☉ Nëse nuk keni një kënd të tillë, zgjidhni një vend në shtëpi ku mund të studioni në mënyrë të rehatshme me laptopin dhe bllokun e shënimeve.
- ☉ Vendosni të gjitha sendet që ju nevojiten afër jush, në mënyrë që të mos detyroheni të ngriheni.

6. Bëni pushime të rregullta

- ☉ Kjo do të ishte këshilla më e zakonshme, por tani mbetet më e rëndësishmja se kurrë ndonjëherë, ndërsa studioni në hapësirën e banesës suaj.
- ☉ Përcaktoni orarin e studimit duke mbajtur parasysh orarin e mësimet të përcaktuar nga pedagogët.
- ☉ Zgjidhni orarin me më tepër rendiment për ju dhe kryeni detyrat e studimit në atë orar.
- ☉ Gjatë ditës, pushimet e herëpashershme do të freskonin mendjen dhe do të ishin mënyra më e thjeshtë për t'u mbrojtur nga lodhja.
- ☉ Largohuni nga laptopi çdo një orë, dhe ndryshoni aktivitetin.
- ☉ Përpiquni të dilni së paku një herë në ditë për shëtitje (nëse është e lejuar).

AFTËSI QË STUDENTËT DUHET TË ZHVILLOJNË PËR TË MËSUAR NË DISTANCË

Vetëmotivimi

Mësimi në distancë në kushtet e karantinës është izolues. Studimi individual pa kontakte me pedagogun dhe bashkëstudentë është një përvojë e studimit të izoluar. Një student i suksesshëm i mësimit në distancë është në gjendje të motivojë veten për të studiuar, edhe kur ai nuk do ta dëshironte këtë.

Këmbëngulja

Një student i suksesshëm i mësimit në distancë ecën përpara edhe kur ndesh sfida. Ai e kupton se fitimi i një diplome është një proces i lodhshëm, por kur lodhesh mund të çlodhesh, por jo ta lesh përgjysëm.

Kërkimi i ndihmës

Një student i suksesshëm i mësimit në distancë e kupton se kërkimi i ndihmës është një pikë e fortë, jo një dobësi. Ai përpiqet të zgjidhë vetë një problem së pari, por nuk heziton të kërkojnë ndihmë, në mënyrë që të mësojë dhe të përparojë.

Studiues i pavarur

Pedagogët synojnë ta mbështesin studentin, por shumica nuk e nxisin studentin që të studiojë intensivisht. Studenti i suksesshëm i mësimit në distancë është një studiues i pavarur dhe merr iniciativë për arsimimin e vet. Ai kërkon ndihmë nga burime të tjera, studentë të tjerë dhe pedagogët. Ai lexon literaturë më tepër sesa është rekomanduar për të kuptuar temat dhe në mënyrë aktive përpiqet të përmirësojë aftësitë e tij të studimit.

Angazhim

Studenti i suksesshëm i mësimit në distancë është i angazhuar në studimet e tij. Ai merr pjesë në diskutime dhe aktivitete në lidhjen në internet. Ai merr pjesë në mësimin sinkron dhe asinkron dhe bën pyetje për të thelluar më tej njohuritë e tij. Ai lexon, konsulton burime të shumta për të thelluar dhe zgjeruar të kuptuarit e lëndëve mësimore.